



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

- **Për:** Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK)

 - **Nga:** Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

 - **Datë:** 4 prill 2024
 - **Lënda:** RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUDHËN 1 janar – 31 mars 2024
-

Gjykata Supreme e Kosovës e ka përmbyllur tremujorin e parë të punës me 596 lëndë të kryera dhe me 303 të pakryera.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar 687 lëndë të reja, derisa gjithsej në punë kanë qenë 899 lëndë.


Numri më i madh i kërkesave të paraqitura përmes mjeteve të jashtëzakonshme juridike në Gjykatë Supreme, ishte;

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë – PML, 220 të pranuar dhe 210 të kryera.

- Revizione 153 të pranuar dhe 147 të kryera,
- Civile të ndryshme, 196 kërkesa të pranuar dhe 123 të kryera.

Shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve 86.75 për qind

Numri i lëndëve të kryera në raport me numrin e lëndëve të pakryera, në këtë tre mujor, i kalkuluar në përqindje, jep këtë pasqyrë në grafikon:



1. Numri i lëndëve të kryera dhe atyre të pakryera

Ndërkaq, shkalla e efikasitetit në zgjidhje të lëndëve, e kalkuluar në përqindje, është 86.75 për qind, duke llogaritur numrin e lëndëve të pranuar dhe atyre të zgjidhura, gjatë periudhës raportuese.

Lëndët e zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 përfshijnë;

210 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë – PML,

147 revizione - Rev,

123 civile të ndryshme – CN

36 kërkesa për zbutje të jashtëzakonshëm të dënimit – PZD,

35 kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm administrativ-ARJ,

16 ankesa administrative – AA

16 revizione ekonomike - E.Rev.


4 revizione administrative - A.Rev.

3 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë civile - CML

2 Administrative të ndryshme - AN

3 kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë kundërvajtje - KML

1 kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë administrative - AML



2. Lëndët e zgjidhura gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, te paraqitura ne grafikon

Seancat e përgjithshme të Gjykatës Supreme

Në tremujorin e parë të vitit 2024, nën drejtimin e kryetarit të Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi është mbajtur një Seancë e Përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të gjykatës, përfshirë edhe gjyqtarët e Dhomës së Posaçme, gjatë të cilës janë miratuar Raporti i Punës së Gjykatës Supreme për vitin 2023 si dhe Plani i Punës për vitin 2024.



3. Seanca e Përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, 23 janar 2024

Takimet, punëtoritë dhe vizitat me rëndësi

Në tremujorin e parë të vitit 2024, Gjykata Supreme me mbështetjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGjK) dhe projektit WBROL-i, ka organizuar takim dyditor, në të cilin kanë marrë pjesë delegacione nga Gjykata e Lartë e Shqipërisë dhe Gjykata Supreme e Malit të Zi.

Gjyqtarët e të tria vendeve kanë shkëmbyer përvojat, me theks në unifikimin e praktikës gjyqësore, pavarësinë e gjyqësorit, të drejtën për proces të rregullt gjyqësor si dhe rëndësinë e bashkëpunimit të tria gjykatave.



4. Takimi trilateral mes gjykatave supreme të Kosovës, Shqipërisë dhe Malit të Zi, 15-16 shkurt 2024

Kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi dhe kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Albert Zogaj, kanë marrë pjesë në Konferencën vjetore të prokurorëve të shtetit, gjatë të cilës, në fjalën e tij të rastit, kryetari Rexhepi theksoi nevojën e zbatimit të Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore si dhe bëri thirrje për përfshirjen e të gjithë akterëve të drejtësisë në angazhimin për të garantuar që gjyqtarët dhe prokurorët të zbatojnë detyrat e tyre në mënyrë të pavarur dhe të drejtë.



5. Kryetari i Gjykatës Supreme në Konferencën vjetore të Prokurorëve të Shtetit, 2 mars 2024

Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Fejzullah Rexhepi, ka pritur në takim ekipin për vlerësimin e sektorit të drejtësisë, INL nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, Michael Wasco, këshilltar i lartë ligjor dhe Dafina Bardhi Rexhepi, specialiste e programit INL. Në këtë takim, kryetari Rexhepi vlerësoi lartë mbështetjen e pakursyer të Ambasadës Amerikane në forcimin e sistemit të drejtësisë, derisa mirëpriti gatishmërinë që kjo mbështetje të vazhdoi në tejkalimin e sfidave aktuale, derisa z. Wasco i konsideroi të një rëndësie thelbësore iniciativat e Gjykatës Supreme dhe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për të përmirësuar gjendjen e përgjithshme në sistemin e drejtësisë.

Programi për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatim të Ligjit (INL) në Kosovë punon në forcimin e sundimit të ligjit dhe fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë, si dhe në njohuritë e publikut për të drejtat e tyre dhe qasjen në drejtësi.



6. Takim me ekipin për vlerësimin e sektorit të drejtësisë, INL, 13 mars

Me mbështetjen e USAID, Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me 14-15 mars kanë mbajtur punëtori dyditore me temë diskutimi - kthimin e çështjeve në rishqyrtim.

Ky takim ka shërbyer për të diskutuar; të gjeturat nga raportet e monitorimeve të gjyqësorit; shkaqet e kthimit të çështjeve në rishqyrtim sipas raportit vjetor; shkeljet e Kodit të Procedurës Penale dhe shkeljet e procedurës kontestimore/përmbarrimore si shkak për kthimin e çështjeve në rishqyrtim; shkaqet për zbatimin e gabuar të ligjit material dhe konstatimit jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si shkak për kthimin e çështjeve në rishqyrtim; çështjet administrative; zbatimi i udhëzuesit për politikë

ndëshkimore dhe sfidat për zbatimin e udhëzuesit; sfidat për trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar; sfidat në trajtimin e rasteve në familjare, trashëgimore dhe rastet e dhunës në familje; sfidat në administrimin e proceseve gjyqësore, masat e sigurimit të pandehurit në procedurë dhe masat e veçanta hetimore; sfidat për zbatimin të Kodit Penal për të Mitur, etj..



7. Punëtorja lidhur me diskutimin e kthimit të çështjeve në rishqyrtim, 14-15 mars 2024

Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Fejzullah Rexhepi bashkë me gjyqtaret Mejreme Memaj dhe Valdete Daka, me mbështetjen e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin - UNODC, kanë vizituar zyrtarisht Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut në Strasburg, ku kanë zhvilluar një varg takimesh me rëndësi. Këto takime kanë shërbyer për të diskutuar tema me interes të përbashkët, me theks në organizimin e gjyqësorit dhe luftimin e krimit të organizuar.



8. Vizita në Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut në Strasburg, 20,21 mars 2024

Puna e Komisionit Këshillëdhënës për Politikë Ndëshkimore

Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore, gjatë tremujorit të parë të këtij viti ka mbajtur një takim dyditor, me qëllim të finalizimit të revidimi të Udhëzuesit të Përgjithshëm të Gjykatës Supreme, për Politikë Ndëshkimore.

Anëtarët e këtij Komisionit, gjyqtarët e degës penale të Gjykatës Supreme, pjesëmarrës në takim dhe përfaqësues të Ambasadës Amerikane, për dy ditë radhazi, diskutuan dhe finalizuan temat e Udhëzuesit që përfshijnë; veprat penale të terrorizmit, veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër martesës dhe familjes, veprat penale të narkotikëve, veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik, veprat penale të armëve dhe veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike.

Në tërë procesin e përpilimit dhe tani revidimit të Udhëzuesit të Përgjithshëm për Politikë Ndëshkimore, Gjykatën Supreme e ka mbështetur Zyra OPDAT nga Ambasada Amerikane në Prishtinë.



9. Takim i Komisionit Këshillëdhënës për Politikë Ndëshkimore, 28-29 mars 2024

Takimet e Asamblesë së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve Mbikëqyrës

Asambleja e Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës nën udhëheqjen e Kryesuesit të Asamblesë, njëherësh Kryetarit të Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi, ka mbajtur një takim gjatë tremujorit të parë të këtij viti, përkatësisht me datë 20 shkurt, ku janë diskutuar një varg çështjesh me rëndësi, si; të gjeturat nga Raporti i inspektimit për identifikimin e arsyeve për hedhjen e kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë si “jo lëndore”; performanca dhe nevoja e ndryshimit në sistemin e vlerësimit; forcimi dhe unifikimi i praktikave gjyqësore; përfaqësimi gjinor në sistemin gjyqësor; qasja e Misionit të EULEX-it për monitorim në qendrat e paraburgimit dhe burgje; plotësimi i vendeve të lira në gjykata etj., dhe kanë dhënë rekomandime për secilën pikë të diskutimit.

Publikimi i vendimeve disiplinore

Bazuar në Ligjin LIGJI Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 9, pika 1.2., kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës është kompetent, për të shqyrtuar ankesat e personave fizik dhe juridik, sa iu përket pretendimeve të tyre për shkelje disiplinore të kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit. Po ashtu, kryetari i Gjykatës Supreme është kompetent për gjyqtarët e gjykatës që drejton.

Në këtë drejtim, gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, bazuar në Ligjin nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, janë pranuar pesë (5) ankesa të palëve, për katër (4) prej tyre është vendosur, një (1) lëndë është në punë, derisa tri (3) prej tyre janë publikuar.

Publikimi i aktgjykimeve dhe aktvendimeve

Gjykata Supreme gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, ka publikuar 819 aktgjykime dhe aktvendime, prej tyre 485 vendime të Gjykatës Supreme dhe 334 vendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Gjatë muajit janar janë publikuar 296 vendime

Gjatë muajit shkurt janë publikuar 143 vendime

Gjatë muajit mars janë publikuar 380 vendime.

Publikimi i vendimeve gjyqësore

819

aktgjykime dhe aktvendime të publikuara gjatë tremujorit të parë të vitit 2024



**RAPORT PËR PUNËN NË GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS NË PRISHTINË
PËR PERIU DHËN 1.01.2024 DERI MË
31.03.2024**

	Të pakryera	Të pranuar	Gjithsej në punë	Të kryera	Te pakryera
Ankesa penale për shkallën e tretë "PA"	0	0	0	0	0
Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë "PML"	57	220	277	210	67
Kërkesë për zbutje të dënimit "PZD"	4	35	39	36	3
Revizion "Rev" "Rev II"	99	153	252	147	105
Mbrojtje e ligjshmërisë "CML"	3	5	8	3	5
Përsëritje e procedurës civile "CPP"	0	4	4	0	4
Civile të ndryshme "CN"	10	196	206	123	83
Revizione ekonomike "E.Rev"	13	12	25	16	9
Mbrojtje e ligjshmërisë "EML"	0	0	0	0	0
Përsëritje e procedurës administrative "APP"	0	0	0	0	0
Mbrojtje e ligjshmërisë administrative "AML"	0	1	1	1	0
A.Rev.	0	4	4	4	0
ARJ	23	39	62	35	27
Ankesa administrative "AA"	3	13	16	16	0
Mbrojtje e ligjshmërisë kundërvajtje "KML"	0	3	3	3	0
Ankesa për paraburgime "PN.II"	0	0	0	0	0
Penale Ndihme Juridike Ndërkombëtare "PNJD"	0	0	0	0	0
Administrative të ndryshme "AN"	0	2	2	2	0
Gjithsej	212	687	899	596	303

Më gjerësisht për Gjykatën Supreme, mund të gjeni duke vizituar adresën: www.gjyqësori-rks.org

Përmbajtja e këtij Raporti dhe dizajni është përgatitur nga Zyra për Informim dhe Komunikim me media e Gjykatës Supreme.

Adresa:

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

Tel: + 381 (0)38 200 18 779/ 038 200 18 775/ 038 200 18 458

Emailadresa: gjykatasupreme@rks-gov.net

Pallati i Drejtësisë, Prishtina e Re